

Reforma zgjedhore – të kthehet vendimmarrja te qytetarët

Sistemi zgjedhor në Kosovë nuk është i përsosur, por i tillë nuk është askund në botë. Ashtu siç nuk është i përsosur as sistemi demokratik. Në të dy rastet ekzistojnë mekanizma të përmirësimit që në vazhdimësi përdoren në kohëra periodike për të bërë përmirsimet e nevojshme që vijnë si nevojë e kohës dhe kërkesës si nga qytetarët, ashtu edhe nga klasa politike.

Reforma zgjedhore në Kosovë ka kohë që kërkohet nga të dyja palët e cekura më lartë. Shoqëria civile ka kohë që ka ndarë mendjen mbi këtë çështje, andaj në vazhdimësi ka kërkuar dhe ka shprehur propozime konkrete se qfarë duhet ndryshuar apo reformuar.

Të gjithë janë të një mendje sa i përket reformës zgjedhore, por edhe pse kjo kërkesë është në agjendë tash e disa vite, dhe sipas rezolutës pro-reformë të Kuvendit të Kosovës një e tillë mbështetet fortë, reforma zgjedhore nuk po ndodhë.

Shkaku kryesor i vonësës të reformës zgjedhore është politizimi i saj nga klasa politike dhe tendenca për ta përdorur reformën për përfitime partiake.

Por, pyetja që duhet bërë është pse na duhet reforma zgjedhore,? A duhet elita politike të ketë frikë? A duhet qytetarët të presin se do të ndodhë mrekulli me reformën? Reforma zgjedhore nuk do të ndryshojë klasën politike e as nuk do t'i demokratizojë partitë politike. Reforma zgjedhore nuk do të bëjë mrekulli për qytetarët e as nuk do t'ju rregullojë gjendjen e tyre sociale.

Reforma zgjedhore na duhet për t'i eliminuar disa probleme që i kemi hasur në të kaluarën dhe për ta avancuar sistemin në atë mënyrë që vota e secilit qytetarë të ketë peshën e vet. Reforma zgjedhore nevojitet për të bërë disa ndërhyrje tenike, por edhe disa ndërhyrje përmbajtësore sidomos pas vendimeve të diskutueshme të Gjykatës Kushtetuese dhe asaj Supreme. Qëllimi final i reformës zgjedhore duhet të mbetet zgjedhjet e lira ku secili qytetarë që merrë pjesë vota e tij të numërohet ashtu siç ai/ajo e ka votuar dhe kjo të reflektohet në formimin e institucioneve që dalin nga vota e lirë.

Sistemi i tanishëm lejon që të ketë devijime nga vullneti i votës së lirë dhe përfaqësimi në Kuvend. Nuk them se me reformën zgjedhore do të kemi një Kuvend më të mirë, por do të kemi më pak deputetë që hynë në Kuvend kundër vullnetit të votuesve.

Shumica e atyre që votojnë pas një kohe nuk e mbajnë mend se cilët pesë kandidatë i kanë votuar sepse disa nga pesëshja e tyre i kanë votuar me porosi, një pjesë nuk i voton fare pesë kandidatët, por asgjë nuk i shpëton komisionerëve syqelë të cilët nuk lejojnë të humbet asnjë votë. Ata bëjnë “detyrën” e qytetarit. Këtu fillon deformimi i vullnetit të qytetarëve, vota e tyre tjetërsohet pasi që mundësia për manipulim të votës së tyre mbetet në ndërgjegjen e komisionerëve të cilët janë deleguar politikisht prej partive politike. Mundësia që të votohen më pak se pesë kandidatë për deputet do të rriste peshën e votës së qytetarit dhe do të ulte mundësinë e manipulimit të kësaj vote, siç e kemi parë në të kaluarën.

E kaluara ka treguar se pas rinumërimit dikush e ka fituar e dikush e ka humbur postin e të zgjedhurit të popullit, por mos të harrojmë se kjo ka ndodhur pasi që janë plotësuar pesëshet nga komisionerët dhe pas “gabimeve” në numërim. Rinumërimi me automatizëm i të gjitha kutive të votimit do të ndikonte në uljen e “gabimeve” në numërim që bëjnë komisionerët politikë.

Votimi me kusht si relik i luftës së vitit 1999 duhet të hiqet. Kjo mundësi e votimit që në shumë raste të dëshmuara është keqpërdorur nuk duhet të ketë vend në sistemin zgjedhor të Kosovës së sotme. Një ditë në katër vite ne si qytetarë duhet të jemi në gjendje të zgjohemi dhe të shkojmë e të votojmë aty ku e kemi emrin. Zgjedhjet e 2017-tës dëshmuar sa e rëndësishme është edhe vetëm një votë, prandaj i tërë procesi e meriton një “sakrificë” qytetare që të votojmë në vendvotimin ku e kemi emrin e të heqim mundësinë e manipulimit përmes votës me kushtë.

Ka edhe disa ndërhyrje teknike që do të përmirësonin procesin zgjedhorë, do ta bënin më të sigurt dhe më të bësueshëm por vendimtare mbetet ndërhyrja substanciale në këtë sistem. Sot mbi të gjitha reforma zgjedhore na nevojitet për t'ia kthyer vendimmarrjen qytetarit, për t'ia kthyer vlerën dhe rëndësinë e votës pasi këtë e ka uzurpuar Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata Supreme me vendimet e saja.

Reforma zgjedhore na nevojitet për ta çliruar Republikën Parlamentare nga kthetrat e gjyqësorit dhe vendimet e tij të ndikuara nga interesi momental i klasës politike. Shumica e 120 deputetëve të zgjedhur nga vota e lirë e qytetarit duhet të zgjedhin se kush do të jetë kryetar i Kuvendit pa asnjë ndërhyrje nga jashtë, nuk ka nevojë as për direktivë të Gjykatës Kushtetuese se kush mund të zgjidhet. Çdonjëri nga 120 deputetët e zgjedhur dhe që arrijnë të marrë 61 vota apo më shumë duhet të ketë të drejtë të zgjidhet si Kryetar i Kuvendit, kështu funksionon demokracia parlamentare e jo me direktiva gjyqësore. Reforma zgjedhore duhet ta bëjë këtë të qartë në mënyrë që të zhvlerësohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu reforma na duhet së pari në ligj, e pastaj të implementohet në praktikë që t'ju pamundësohet atyre që kanë kryer vepra penale të mos mund të kandidohen. Atë që e kemi sot e ka zhvlerësuar vendimi i Gjykatës Supreme me arsyetimin e shkeljes së të drejtave të njeriut.

Ndryshimet e përmendura dhe ato që nuk janë përmendur në këtë shkrim janë në funksion të Republik[s Parlamentare atë që ne synojmë të kemi. Këto ndryshime janë për ta përmirësuar procesin zgjedhor dhe për t'i eliminuar disa problem që ndikojnë në tjetërsimin e vullnetit të qytetarëve. Ndryshimet substanciale kanë të bëjnë më kthimin e vendimmarrjes të qytetarët dhe largimin e ndikimit të politikës përmes gjyqësorit se kush duhet zgjedhur në cil[nd] pozitë.

Qytetarët i zgjedhim përfaqësuesit e tyre përmes votës së lirë, ata i zgjedhin institucionet përmes vullnetit të lirë dhe këtu në mes nuk duhet të ketë ndërhyrje nga askush dhe nga asnjë institucion tjetër, këtë duhet ta garantojë reforma zgjedhore.

Selatin Kllokoqi është politolog me profesion. Gjatë karrierës së tij ka punuar në organizata të ndryshme ndërkombëtare në Kosovë, në organizata vendore të shoqërisë civile si dhe në institucione qeveritare të nivelit qendror. Fushat kryesore të angazhimit të tij janë, zgjedhjet, qështjet sociale, dialogu si dhe integrimet evropiane.